



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural
Development**

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1.3 (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 4 paragrafi 4, neni 5 paragrafi 5, neni 57 Ligji Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, dt. 7 nëntor 2008,
Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 13/2009

Për caktimin e kushteve, objekteve dhe pajisjeve për vendosjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve

**Neni 1
Qëllimi**

1. Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kushtet e objekteve dhe pajisjeve për vendosje në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve.
2. Ky udhëzim administrativ rregullon klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

**Neni 2
Kushtet teknike ndërtimore**

1. Çdo objekt - lokal për tregtim të produkteve për mbrojtjen e bimëve, përveç kushteve teknike ndërtimore të cilat i përcakton organi kompetent komunal, duhet t'i plotësoi edhe këto kushte, të jetë:
 - I ndërtuar në vende me dendësi më të vogël të njerëzve dhe kafshëve;
 - Larg ujërave rrjedhës;
 - Larg fabrikave për prodhimin dhe përpunimin e ushqimit, dhe
 - Larg institucioneve edukativo-arsimore.
2. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni objekti – lokali në të cilën vendosen produktet për mbrojtjen e bimëve, duhet të plotësoi edhe këto kushte të veçanta:

- 1.1 Të jetë i siguruar - rrethuar dhe të ketë kanalin në të cilin do të pamundësohej shpërndarja e tyre;
 - 1.2 Të jetë i mbrojtur nga drita dhe nxehtësia direkte si dhe të ketë ndriçim të mjaftueshëm;
 - 1.3 Të jenë të ndara fizikisht nga ato të ndezshme prej atyre të pandezshme;
 - 1.4 Të ketë dysheme të fortë dhe e pa depërtueshme në rast të derdhjes së tyre;
 - 1.5 Të siguroj që lagështia dhe temperatura në hapësirat e ruajtjes të jenë optimale, dhe të mirëmbahen raftet e produkteve;
 - 1.6 Të jetë i pajisur me mjete teknike dhe sanitare mbrojtëse në punë si: aparatën për fikjen e zjarrit, kutinë me pajisje për ndihmën e parë, ventilim të përhershëm si dhe të posedoi nyje higjieno – sanitare;
 - 1.7 Të jetë i pajisur me shenjën paralajmëruese të cilat tregojnë “RREZIK NGA PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE”.
3. Produktet për mbrojtjen e bimëve me shenjën T+ duhet të jenë të mbyllura në rafte të veçanta.

Neni 3

Në depot apo barnatoret bujqësore që janë të dedikuara për tregtim të produkteve për mbrojtjen e bimëve ndalohet mbajtja dhe tregtimi i artikujve të tjerë, prodhimeve ushqimore për njerëz, kafshë, shpezë si dhe ndalohet ri ambalazhimi i tyre.

Neni 4

Ambalazhimi i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve

1. Produktet për mbrojtjen e bimëve, duhet të jenë me ambalazh origjinal nga kompania prodhuese.
2. Ambalazhimi i Produkteve nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet t'i plotësoj kërkesat si vijon:
 - 1.1 Të jetë i prodhuar në mënyrë të atillë që mos të lejoj derdhjen apo rrjedhje në mjedis gjatë ruajtjes, transportit;
 - 1.2 Materiali prodhues i ambalazhit të mos shkatërrohet nga kontakti me produktet e mbrojtjes së bimëve që ndodhet brenda tij,
 - 1.3 Të mos krijojnë lëndë të rrezikshme nga veprimi kimik;
 - 1.4 Të gjitha pjesët e ambalazhit të jenë të qëndrueshme në kushte normale të transportit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit dhe
 - 1.5 Ambalazhimi që përmban produkte për mbrojtjen e bimëve të klasifikuara, duhet të ketë të shënuar një udhëzim rreziku paralajmërues në rast kontakti me të, të jetë i mbyllur nga kompania prodhuese dhe i vulosur.

Neni 5

Etiketimi

1. Në ambalazh, duhet të vendoset etiketa në gjuhen e përdoruesit.
2. Etiketa përmban të dhënat e produkteve për mbrojtjen e bimëve:
 - 1.1 Emrin tregtar;
 - 1.2 Substancat aktive;
 - 1.3 Periudha e pritshmërisë – karenca;

- 1.4 Doza e përdorimit të shprehura në sistemin metrik për kulturat dhe kushtet specifike bujqësore, agroteknike dhe mjedisore;
 - 1.5 Kushtet e ruajtjes;
 - 1.6 Afati i skadimit;
 - 1.7 Rreziqet e veçanta ndaj njerëzve, kafshëve dhe mjedisit;
 - 1.8 Masat për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve dhe mjedisit;
 - 1.9 Shenjat e përgjithshme, në rast helmimi, udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla mjekësore;
 - 1.10 Tipi i produkteve si insekticid, herbicid;
 - 1.11 Sasia neto e produkteve apo e lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë;
 - 1.12 Mënyra e veprimit: sistemik, kontakti me veprim para mbrojtjes, kurativ.
3. Kur të dhëna në etiketë nuk mund të përfshihen atëherë, duhet të cekën në udhëzimin e përdorimit.
 4. Ndalohet në etiketë që të bëhen korrigjime, fshirje ose vendoset etiketë tjetër.

Neni 6 Klasifikimi

1. Produktet për mbrojtjen e bimëve të importuara, duhet të jenë të klasifikuara.
2. Të dhënat e produkteve të klasifikuara nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të shënohen në etiketë ose udhëzimin e përdorimit, duke u bazuar në veprimin specifik në shëndetin e njeriut, bazuar në toksicitetin e tyre, dhe në veprimin ndaj mjedisit hapësinor.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohet neni 10 dhe 11 Udhëzimit Administrativ Nr.01/2004 për caktimin e kushteve për licencimin e importuesve të pesticideve për tregtimin dhe deponimin e pesticideve, dt.12 shkurt 2004.

Neni 8

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet sipas nenit 55 paragrafi 1 pika 1.1 Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

Neni 9 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 08.09.2009

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Idriz Vehapi
